

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Ardian Dvorani	Kryesues
Evelina Qirjako	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar

Në datën 12.07.2017 mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen që ju përket palëve :

PADITËS: ADRIAN FULLANI

PADITUR: KUVENDI I SHQIPËRISË
BANKA QENDRORE E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT

OBJEKTI:

Konstatimi i pavlefshmërisë absolute dhe / ose shfuqizimi tërësisht për shkak të paligjshmërisë së shkarkimit nga detyra e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe Anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të akteve:

Vendimit nr.52 datë 06.09.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

Vendimit nr.ska, datë 11.09.2014 dhe 18.09.2014 të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me dërgimin në mbledhje plenare të propozimit për shkarkim të paditësit nga detyra e Guvernatorit dhe Anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës;

Vendimit nr.64 datë 18.09.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe zgjidhjen e pasojave.

Shpërblimin e dëmit pasuror dhe jo pasuror të shkaktuar nga veprimet e paligjshme të palëve të paditura;

Detyrimi i palëve të paditura të shpërblejnë paditësin duke i njohur atij të drejtën e shpërblimit për detyrën e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe/ose Anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Republikës së Shqipërisë që prej datës së shkarkimit 18.09.2014 deri në datën e përfundimit të mandatit që është data 17.11.2018 në masën 35.448.650 lekë.

Detyrimin e të paditurve të shpërblejnë paditësin për dëmin jo pasuror në masën 15.000.000 lekë.

Baza Ligjore: Neni 42/1, 44, 131, 134, 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut neni ; nenet 42, 43, 44, 45, 47, 53 të ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar

; neni 1, 2, 4, 9, 10, 14, 46 e vijim, 105, 106, 107, 108, 109, 115, 116, 118, 119 të ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”; Nenet 608, 609, 625 e vijim të Kodit Civil; nenet

2, 7 a, 11, 15 a, 16, 17, 17/1 a dhe c f, 21, 40 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.166 datë 16.12.2004 i ndryshuar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr.2777 (80-2016-2776), datë 02.06.2016 ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së paditësit Adrian Fullani.

2. Detyrimin e të paditurit Banka e Shqipërisë, që në cilësinë e punëdhënësit të paguajë paditësin Adrian Fullani, me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore në funksionin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.
3. Rrëzimin për pjesën tjetër të objektit të padisë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin Nr.843 (86-2017-829), datë 01.03.2017 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit Nr.2777 (80-2016-2776), datë 02.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Shfuqizimin e vendimit nr.64 datë 18.09.2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

Detyrimin e palës së paditur Banka e Shqipërisë t'i paguajë paditësit Adrian Fullani pagat që do të përfitonte në detyrën e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, si dhe të Anëtarit të Këshillit të Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën që ky mandat do të përfundonte sipas ligjit.

Rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ka ushtruar rekurs pala e paditur Kuvendi i Shqipërisë, duke parashtruar këto shkaqe:

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ka ushtruar rekurs edhe pala paditëse Adrian Fullani...

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ka ushtruar rekurs pala e paditur Banka e Shqipërisë...

Kundër Rekursit të palës së paditur Kuvendi i Shqipërisë dhe palës së paditur Banka e Shqipërisë, ka ushtruar Kundër-Rekurs pala paditëse Adrian Fullani, ...

Kundër Rekursit të palës paditëse Adrian Fullani, ka ushtruar Kundër-Rekurs pala e paditur Banka e Shqipërisë...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 63 të ligjit Nr.49, datë 03.05.2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit Nr.843 (86-2017-829), datë 01.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në këtë ndryshim:

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.64 datë 18.09.2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

Tiranë, më 12.07.2017
**Nr.31003-01272-00-2017 i Regj. Themeltar
Nr.00-2017-1866 i Vendimit (768)**